



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 25.07.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 24.07.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Kibernetika" SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të teknologjisë informative", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-4075-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-054-521, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e vonuar- jashtë afatit kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Kibernetika" SH.P.K., e dt.24.07.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të teknologjisë informative", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-4075-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-054-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 18.07.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 18.07.2025;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Kibernetika" SH.P.K., me dt.24.07.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të teknologjisë informative", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-4075-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-054-521,.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, nuk ka bërë pezullimin e lëndës, sepse Operatori ekonomik ankues ka bërë Kërkesë për rishqyrtim pas afatit ligjor(neni 60 paragrafi 60.1 nën b, të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024.

Kërkesa për rishqyrtim, është dorëzuar me dt.24.07.2025, kurse dita e fundit për dorzëimin e kërkesës për rishqyrtim ka qenë dt.23.07.2025, prandaj e njehta refuzohet si e vonuar, sepse nuk është dorëzuar brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 60.1 (b), të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024 ;

60.1 Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni "kërkesat për rishqyrtim" brenda afateve të mëposhtme:

b) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK (B58) është dita (0).

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunes;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit